



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 01-060-01-10005-25

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg. _____

Data / Datum / Date 14.04.2025



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.24.03.2025, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Bajram Hashani, Labinot Mirena, Sami Ahmeti, Albana Shillova Shalaku dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë:

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i kërkesës për dhënien në debat publik të Rregullores për ndarjen e bursave, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore
4. Raporti nga Komisioni për monitorim të realizimit të kontratave
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimi e kërkesës për dhënien në debat publik të Rregullores për ndarjen e bursave, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore

Enver Gashi – Ne si grup jemi që kjo Rregullore të merrë aprovimin në Kuvend, pastaj të kalon në debat publik.

Sami Ahmeti – Sa i përket pikës së rendit të ditës, ne jemi dakord që kjo të shkoj në mbledhjen e Kuvendit Komunal dhe atje të merrë pëlqimin që të dalë në debat publik, ndërsa për më vonë nëse kemi mundësi për me dhënë ndonjë kontribut jemi në dispozicion.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e kërkesës për dhënien në debat publik të Rregullores për ndarjen e bursave, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti raportin nga Komisioni për monitorim të realizimit të kontratave.

Enver Gashi – Është një raport periodik që bëhet çdo 6 muaj, është raport i mirë sepse është me kohë dhe ne jemi për atë që kjo pikë të shkoj në Kuvend.

Sami Ahmeti – Ne jemi dakord që kjo pikë të shkoj në Kuvend dhe po ashtu kërkojmë që hartuesit e raportit, përfaqësuesi i tyre të shtë mirë me qenë në seancë që nëse, kemi ndonjë vërejtje me na dhënë arsyetime.

Kryesuesja – E kemi edhe raportin tjetër të Komisionit për monitorim të realizimit të kontratave, që juve si material iu ka ardhë. Pra, janë 2 raporte të ndara.

Enver Gashi – Edhe për këtë raport jemi për atë që të shkon në Kuvendin Komunal.

Sami Ahmeti – Është pikë e njejtë e rendit të ditës, janë 2 raporte me të njejtën përmabjtje, do të thotë për më shumë operatorë ekonomik që janë marrë, do të jemi shumë dakord që të shkoj në seancë ndërsa, atje bisedojmë.

Kryesuesja – Për arsye të numrave të protokolit mua më është dashtë me i përmend 2 raportet.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal Raportin nga Komisioni për monitorim të realizimit të kontratave.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Ju njoftoj se pasi ua kemi dërguar materialin, kanë ardhë 2 kërkesa dhe nëse, ju jeni dakord me i lexue sot.

Sami Ahmeti – Në fakt, ne njëfarë marrëveshje e kemi çdo gjë që vjen duhet të kaloj edhe përmes Drejtorive, kështë që është e panevojshme të lexohen, por le të dërgohen në Drejtoritë përkatëse dhe jemi në rregullë. Mirëpo, gjithsesi me mbarimin e kësaj seance është mirë që ta kemi si material shtesë.

Enver Gashi – Unë kërkesat i pashë më heret, i lexova dhe kërkesat i përkasin Kuvendit, e jo Drejtorive prandaj bën që ti dërgohen Kuvendit.

Kryesuesja – Ju sqaroj se këto kërkesa kanë të bëjnë me një vendim të Kuvendit, dhe ne pas mbledhjes mundemi me ua dërgue. Mendoj se këto kërkesa duhet të shqyrtohen në Kuvend, dhe njëra është nga Abdyrrahman Krasniqi si anëtar i Grupit punues për trajtimin e lëndës Shkabaj SH.P.K. i cili ka dhënë dorëheqje nga ky Komision.

Sami Ahmeti – Kjo është vetëm dorëheqje dhe nuk është se çka po dojmë ne të bëjmë si Kuvend Komunal. Nëse, është ndonjë kërkesë prej Ekzekutivit që ne me bë zëvendësimin e tij sepse kështu po nënkupton, por jemi dakord që të shkon në seancë të Kuvendit, nuk është kurrfarë problemi.

Kryesuesja – E kemi kërkesën tjetër për informim nga Gafurr Elshani lidhur me shqyrtimin e kërkesës së Ndërmarrjes Shkabaj nga Grupi i Punës, i emëruar nga Komuna e Obiliqit, Kuvendi Komunal. Atëherë, a jeni për atë që këto 2 kërkesa ti rekomandohen Kuvendit Komunal dhe të grupit punues, nëse ata kanë një raport kanë qenë të obliguar në njëfarë forme me i raportue edhe Kuvendit Komunal.

Sami Ahmeti – Ne jemi dakord që ti rekomandohet Kuvendit sepse pjesa e parë ka lidhje me të dytën, po bëhet fjalë për të njejtin Komision. Pasi që veç e dhashë pëlqimin me shkue në seancë pika paraprake mua mu kujtua që është mirë dikush që ka marrë pjesë në një Komision me bë një raport, kështu që edhe vetë personi paska kërkuar një raport për këtë punë se çka është bërë prej themelimit të këtij Komisioni deri në këtë rast. Unë e kuptoj që z.Abdyrrahman ka ndërrue pozicion prej një Drejtorie në një Drejtori tjetër, por është jonormale me marrë pjesë në një Komision pastaj veç me dalë pa dhënë ndonjë raport pasi që Kuvendi e ka miratuar këtë Komision, Ne jemi dakord që të dy kërkesat të shkojnë bashkë në seancë të Kuvendit Komunal.

Kryesuesja – Ju mirë e thatë se ai mund të japë dorëheqje, por paraprakisht deri me këtë datë është dashtë me u sjellë një raport për punën e Komisionit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e kërkesës për informim nga Gafurr Elshani lidhur me shqyrtimin e kërkesës së Ndërmarrjes Shkabaj nga Grupi i Punës, i emëruar nga Komuna e Obiliqit, Kuvendi Komunal.


Pika 6 e rendit të ditës

Labinot Mirena – Unë e kam një kërkesë lidhur me disa ndërtime shumë të vjetra siç është një shtëpi këtu, në rrugën nga rrethi i Obiliqit që shkon poshtë që është e pabanueshme, është e djegur prej luftës dhe nuk e di kush është pronari i saj. Mirëpo, besoj se është e rrezikshme me qenë ajo shtëpi në Komunën e Obiliqit, dhe mendoj se duhet me rrethue atë pjesë. Po ashtu, i kemi edhe disa objekte në Palaj që përbëjnë rrezikshmëri të lartë për shkak se në këto dy lokacione që po i përmendi unë udhëtojnë shumë nxënës që shkojnë në shkollë. Ne e kemi një rast shumë të freskët në Istog, ose në Pejë nëse nuk gaboј ku një shtëpi është shembë dhe i ka zënë disa të rinjë aty brenda, kështu që më mirë është me marrë ndonjë vendim, ose me iu bё kërkesë atyre pronarëve që me i rrethue ato objekte të tyre, ose nëse janë në gërmadha me marrë një vendim me i rrënue që mos me qenë të rrezikshme për qytetarët që frekventojnë në atë pjesë. Në Palaj ka jashtëzakonisht shumë nga pjesa e trotuarit që shkojnë fëmijët në shkollë dhe po shfrytëzohen për deponi ilegale që po hedhin mbeturina, është rrezik edhe prej qenve endacakë dhe prej lloј lloј sëmundjeve. Ndërsa, kjo këtu në Obiliq që është te rrethi aty poshtë që vazhdon nga Hashanët, është dykatëshe që paraqet rrezik shumë më të madh se ajo në Palaj. Kërkoј prej Drejtorisë për planifikim urban kadastër dhe pronë dhe prej Drejtorisë së shërbimeve publike që me ndërmarrë masa në këto raste.


Kryesuesja – Ne si gjithmonë do të ia dërgojmë Drejtorive kërkesën tënde dhe në mbledhjen e radhës mund të keni ndonjë përgjegje prej Drejtorive përkatëse.

Mbledhja përfundoi në ora 11:20’

Bashk. prof. për punë të KK


Azize Zeneli

Kryesuesë e KPF


Vlora Mjekiqi Kabashi

